



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHETËTORË I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020.

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

Mos sigurimi i dokumentacionit të rregullt për shfrytëzimin me mjete me para në dorë dhe nuk është kryer regjistrimi i mjeteve me para me gjendjen më 31 dhjetor.

Vlerësimi i pozicioneve individuale të bilancit të përfshira në librin kryesor nuk kryhet në pajtim me parimin e kontabilitetit të paraqitjes së modifikuar të ndryshimeve/transaksioneve afariste.

Mendimi i dhënë/përfundimi *: ●

Shprehën mendim të pavalitshëm për të vërtetën dhe objektivitetin të raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

Gjatë tërheqjes së mjeteve me para në dorë dhe përdorimit të tyre, të sigurohet dokumentacioni i rregulluar dhe i besueshëm për dedikimin e tyre, të kryet regjistrimi mjeteve me para dhe pas përfundimit të procedurës së nisur pranë autoriteteve kompetente, të merren masa dhe aktivitete për veprimin përkatës për mjetet e tërhequra. Evidentimi i ndryshimeve afariste të kryet në përputhje me parimin e kontabilitetit të paraqitjes së modifikuar të ndryshimeve dhe transaksioneve afariste.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Të rishikohet dispozita ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt; saktësimi në pjesën e donacioneve nga partia politike, në lidhje me limitet individuale dhe totalit të mjeteve, ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore me të cilën rregullohet mënyra e mbajtjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe rregullimin e mënyrës së pagesës dhe evidentimit të anëtarësisë si burim i financimit.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Janë marrë vërejtje të draft-raportit të revizorit të autorizuar shtetëror gjatë të cilës është vlerësuar se të njëjti paraqesin njoftime.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Përgjigja e vërejtjeve është dhënë në bashkëngjitje të këtij raporti përfundimtar.

* ● pozitive ● me rezervë ● të pavalitshëm ● të përmbajtur